



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**AUTORITETI PËR INFORMIMIN MBI DOKUMENTET E ISH-SIGURIMIT TË SHTETIT
SEKRETARI I PËRGJITHSHËM**

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më . ____ . ____ .2022

Lënda: Përgjigje kërkesës së paraqitur nga reporteri i G2 Media

G2 Media (A2 CNN)

Adresa : Rr. Papa Gjon Pali II, Kati 10, ABA Business Center

TIRANË

I nderuar z. Koçi,

Në përgjigje të kërkesës tuaj për informacion, nëse ka pasur persona të zgjedhur të implikuar me organet e ish –Sigurimit të Shtetit në legjislaturën e VIII (tetë) deri në legjislaturën e X-(dhjetë)-të të Kuvendit të Shqipërisë, kërkesë e paraqitur në rrugë elektronike pranë Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish- Sigurimit të Shtetit (Autoriteti), Ju informojmë si më poshtë:

Së pari : Në zbatim të ligjit nr. 45/2015 “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë” i ndryshuar, Autoriteti, nuk e nis procedurën e verifikimit të pastërtisë së figurës kryesisht ose me iniciativën e tij, por vetëm pasi të bëhet kërkesa në rastin konkret nga subjektet politike/kandidatët për deputetë në Kuvendin e Shqipërisë për qëllime të përmbushjes së funksioneve të tij.

Së dyti : Autoriteti që në fillim të punës së tij si institucion (në fund të vitit 2016), ka zhvilluar fushata sensibilizuese e promovuese, nisur nga rëndësia që ka për shoqërinë shqiptare pasja e figurave të pastra të kandidatëve për tu zgjedhur në organin më të lartë të legjislativit. Në këtë kuadër me shkresë drejtuar gjithë partive politike ka kërkuar bashkëpunimin e tyre me Autoritetin që për qëllime të transparencës së figurës, gjatë fushatave elektorale, ti drejtohen me kërkesë për verifikimin të figurës së kandidatëve për deputetë në Kuvendin e Shqipërisë.

Në përgjigje dhe mbështetje të fushatës sensibilizuese të Autoritetit, për zgjedhjet parlamentare elektorale të zhvilluara përkatësisht në qershor 2017 (legjislatura e nëntë), nga 18 parti të regjistruara në zgjedhje, vetëm dy parti politike e konkretisht PBDIU dhe Aleanca Popullore për Drejtësi, kanë paraqitur kërkesë për verifikim të kandidatëve për deputet. U verifikuan 285 persona, nga të cilët 4 persona figurojnë në dokumentacionin e ish-Sigurimit të Shtetit. Vendimet e Autoritetit u janë dërguar subjekteve kërkuese. Partitë e tjera të regjistruara në zgjedhjet parlamentare të vitit 2017 nuk kanë paraqitur kërkesë pranë Autoritetit.

Ndërkohë me initiative personale vetëm 5 (pesë) deputetë të Kuvendit të legjislaturës 2017-2021, kanë paraqitur kërkesë për verifikim të pastërtisë së figurës pranë Autoritetit. Mbi bazën e dokumentacionit të administruar nga Autoriteti nuk kanë rezultuar të dhëna në dokumente të ish Sigurimit në emër të tyre.

Së treti: Autoriteti edhe në vitin 2021 i është drejtuar me shkresë të 31 partive politike të regjistruara në zgjedhjet parlamentare për vitin 2021, që të bashkëpunojnë me Autoritetin dhe ti drejtohen me kërkesë për verifikimin e kandidatëve në garë për deputetë në Kuvendin e Shqipërisë.

Vetëm katër subjekte politike ABDE, ALEANCA, PADSH dhe PBD, të regjistruara në zgjedhje me gjithsej 161 kandidatë, kanë marrë në konsideratë këtë proces të rëndësishëm për integritetin e zgjedhjeve dhe kanë paraqitur kërkesën për verifikim të kandidatëve për deputetë për zgjedhjet parlamentare të vitit 2021. Mbi bazën e dokumentacionit të administruar nga Autoriteti, **vetëm për një kandidat** për deputet kane rezultuar dokumente të ish-sigurimit të shtetit në emër të tij ku figuron si Bashkëpunëtor i ish Sigurimit , ndërsa 160 rezultojnë pa dokumente. Partitë e tjera të regjistruara në zgjedhje nuk kanë paraqitur kërkesë pranë Autoritetit.

Me iniciative personale vetëm 2 (dy) deputetë të Kuvendit të legjislaturës 2021-2025, kanë paraqitur kërkesë për verifikim të pastërtisë së figurës pranë Autoritetit. Mbi bazën e dokumentacionit të administruar nga Autoriteti nuk kanë rezultuar të dhëna në dokumente të ish Sigurimit në emër të tyre.

Së katërti : sipas dispozitave të ligjit nr. 45/2015 i ndryshuar, verifikimi i figurës së kandidatëve për deputetë në Kuvendin e Shqipërisë, kryetarë bashkish dhe kryetarë këshilli qarku, në lidhje me ekzistencën për ta të informacioneve në dokumente të ish-Sigurimit të Shtetit, kryhet për qëllime të transparencës së figurës, gjatë fushatave elektorale, dhe jo si kusht apo detyrim ligjor i parashikuar për tu plotësuar për kandidatët për deputet.

Së fundmi; roli që ligji i njeh Autoritetit në këtë drejtim është mjaftueshmërsht i drejtpërdrejtë, vënie në dispozicion të informacionit sipas kërkesës. Vlerësimi i rezultateve të verifikimeve të kandidatëve mbetet në diskrecion të institucionit kërkues, për sa i takon kushteve penguese për t'u zgjedhur.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

Kordinatori i të drejtës për informim pranë Autoritetit

L. Cocoli

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Në mungesë dhe me Urdhër

Drejtori i Informacionit

Selami Zalli